

BANKA E SHQIPËRISË

# ANALIZË E ZHVILLIMEVE NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË

TREMUJORI III - 2019

*Enian Çela*

*Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë*

JANAR 2020

*Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*



# P Ë R M B A J T J A

<i>Hyrje</i>	4
<i>I. ZHVILLIMET KRYESORE NË BILANCIN E PAGESAVE</i>	5
<i>II. LLOGARIA KORRENTE</i>	7
<i>III. LLOGARIA KAPITALE</i>	10
<i>IV. LLOGARIA FINANCIARE</i>	10
<i>V. PROFILI I FINANCIMIT TË DEFICITIT KORRENT</i>	12



## I. ZHVILLIMET KRYESORE NË BILANCIN E PAGESAVE<sup>1</sup>

Deficiti i llogarisë korrente u raportua në 161.2 milionë euro për tremujorin e tretë të vitit 2019<sup>2</sup>, duke u zgjeruar me rreth 10.1% në terma vjetorë. Kontributi kryesor në këtë drejtim ka buruar nga nënlllogaria e mallrave, me ndikime edhe nga nënlllogaria e të ardhurave parësore. Deficiti korrent u vlerësua në nivelin 4.6% ndaj PBB-së, ose 0.1 pikë përqindjeje më i lartë se i njëjti tremujor i një viti më parë. Në këtë drejtim ka ndikuar mbyllja e tepricës pozitive në raportin kursime-investime në sektorin publik (shih hapësirën informuese për “Zhvillimet në hendekun e kursimeve dhe investimeve”).

Deficiti tregtar në mallra dhe shërbime u zgjerua me rreth 4.8% në terma vjetorë. Deficiti tregtar në mallra dha ndikimin kryesor duke u zgjeruar me 11.3%. Suficiti i shërbimeve ndikoi në kah të kundërt pasi u zgjerua me rreth 17.5% krahasuar me një vit më parë.

Eksportet e mallrave dhe të shërbimeve shënuan një rritje prej 8.4% në terma vjetorë. Kontributi lidhet tërësisht me dinamikën e eksportit të shërbimeve, i cili u zgjerua me 11.3% krahasuar me një vit më parë. Rritja e eksportit të shërbimeve lidhet kryesisht me zgjerimin e eksporteve për “shërbimet e udhëtimit” (14.5% në terma vjetorë). Nga ana tjetër, eksporti i mallrave vazhdoi prirjen e ngushtimit krahasuar me një vit më parë, por me ritme më të zbutura krahasuar me tremujorin e dytë. Rënia vjetore shënoi 3.9%.

Importet e mallrave dhe shërbimeve u zgjeruan me 7.6% në terma vjetorë. Ndikime kryesore pozitive kanë ardhur nga mallrat. Në këtë rast, rritja vjetore ka shënuar 7.6%. E njëjta normë rritjeje vihet re edhe në rastin e shërbimeve. Ndikimi kryesor lidhet përsëri me “shërbimet e udhëtimit”, të cilat u rritën me rreth 8.5% në terma vjetorë.

Llogaria e të ardhurave parësore rezultoi me tepricë negative në nivelin 39.9 milionë euro, ndërkohë që një vit më parë shënonte një tepricë negative prej 17.1 milionë euro. Zgjerimi i tepricës negative lidhet me rritjen e të ardhurave dalëse të lidhura me investimet direkte. Nga ana tjetër, suficiti i llogarisë së të ardhurave dytësore u zgjerua me 10.9% në terma vjetorë. Përcaktues në këtë drejtim kanë qenë prurjet neto të “Remitancave”, të cilat u rritën me rreth 8.6%. Flukset hyrëse neto në llogarinë kapitale shënuan 19.7 milionë euro

<sup>1</sup> Të dhënat më të fundit të bilancit të pagesave i përkasin tremujorit të tretë të vitit 2019. Duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2008, Banka e Shqipërisë harton Statistikat e Bilancit të Pagesave, në përputhje me standardet ndërkombëtare të parashikuara në Manualin e 6-të të Bilancit të Pagesave, publikuar nga FMN-ja. Ndryshimet kryesore mes metodologjisë aktuale dhe të mëparshme sintetizohet në udhëzuesin e mëposhtëm:

[http://www.bankofalbania.org/web/pub/shpjegues\\_per\\_ndryshimet\\_ne\\_publicimin\\_e\\_statistikave\\_te\\_sektorit\\_te\\_jashtem\\_sipas\\_bpm6\\_qershor\\_2014\\_2\\_6688\\_1.pdf](http://www.bankofalbania.org/web/pub/shpjegues_per_ndryshimet_ne_publicimin_e_statistikave_te_sektorit_te_jashtem_sipas_bpm6_qershor_2014_2_6688_1.pdf)

Për efekt analizash, të dhënat e Bilancit të Pagesave, nga viti 2002 deri në vitin 2007, u riklasifikuan në përputhje me metodologjinë e re nga Departamenti i Politikës Monetare.

<sup>2</sup> Në fund të materialit gjendet një tabelë përmbledhëse për zhvillimet kryesore të Bilancit të Pagesave gjatë periudhave të fundit përfshirë tremujorin në analizë.

dhe rezultuan rreth 3.2 milionë euro më të ulëta kundrejt të njëjtit tremujor të një viti më parë.

Në llogarinë financiare, janë regjistruar detyrime neto në vlerën 15.4 milionë euro, rreth 8.8% më të ulëta krahasuar me një vit më parë. Flukset hyrëse të investimeve direkte u zgjeruan me rreth 1.4%, por në terma neto u pakësuan me 1.9%. Flukset neto hyrëse në llogaritë kapitale e financiare arritën të mbulojnë 21.8% të deficitit të llogarisë korrente, duke rezultuar në flukse hyrëse për zërin "gabime dhe harresa". Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me një shtim të mjeteve të rezervës me rreth 109.7 milionë euro. Stoku i rezervës valutore në fund të tremujorit të tretë të vitit 2019, është në gjendje të mbulojë 6.7 muaj import mallrash dhe shërbimesh ose 160% të borxhit të jashtëm afatshkurtër bruto.

## II. LLOGARIA KORRENTE

Deficiti i llogarisë korrente u raportua në 161.2 milionë euro në tremujorin e tretë të vitit 2019, duke u zgjeruar me rreth 10.1% në terma vjetorë. Deficiti u vlerësua në nivelin 4.6% ndaj PBB-së nominale ose rreth 0.1 pikë përqindje më i lartë se i njëjti tremujor i një viti më parë. Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2019, raporti është 3.1 pikë përqindje më i ulët.


Zgjerimi në terma vjetorë është përcaktuar kryesisht nga nënlllogaria e tregtisë së mallrave, me ndikime suplementare nga të ardhurat parësore. Deficiti tregtar në mallra u zgjerua me rreth 11.3%, ndikuar kryesisht nga rritja e importit të mallrave me 7.6%. Nga ana tjetër, ka vazhduar rënia në terma vjetorë e eksportit, por me ritme më të zbutura krahasuar me tremujorin e mëparshëm (3.9% në tremujorin e tretë kundrejt 12.8% në tremujorin e dytë 2019).

Suficiti i nënlllogarisë së "shërbimeve" u zgjerua me 17.5% në terma vjetorë. Ndikimi kryesor ka buruar nga rritja e eksportit të shërbimeve me 11.3%. Kontributi themelor ka ardhur nga rritja e shpejtë e "shërbimeve të udhëtimit" me 14.5%. Nga ana tjetër, rritja e importit të shërbimeve regjistroi 7.6% ndikuar edhe në këtë rast nga rritja e importit të "shërbimeve të udhëtimit" me 8.5% krahasuar me një vit më parë.

Bilanci neto i llogarisë së të ardhurave parësore rezultoi me një tepriçë negative prej 39.9 milionë eurosh, ndërkohë që një vit më parë shënonte 17.1 milionë euro. Zgjerimi i deficitit lidhet me rritjen e të ardhurave dalëse të investimeve të huaja direkte. Paralelisht, raportohet një rritje e të ardhurave hyrëse nga punësimi, por e pamjaftueshme për të kompensuar impaktin nga të ardhurat e investimeve. Suficiti i nënlllogarisë së të ardhurave dytësore, u zgjerua me rreth 10.9% në terma vjetorë. Flukset hyrëse të remitançave dhanë ndikimin themelor, pasi u rritën me rreth 8.4%.


Të ardhurat neto kumulative nga llogaria e shërbimeve, e të ardhurave parësore dhe atyre dytësore, financuan rreth 80.5% të deficitit tregtar të mallrave. Ky raport është 0.2 pikë përqindje më i lartë krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2018 dhe 16.3 pikë përqindje më i lartë krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

Grafik 1. Kontributi sipas kategorive (pikë përqindje) në ecurinë vjetore të deficitit korrent (%)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 2. Zërat kryesorë në llogarinë e shërbimeve (flukse neto në milionë euro)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3. Bilanci i të ardhurave parësore (flukse neto, në milionë euro, majtas) dhe të ardhurat nga investimet direkte (flukse neto, në milionë euro, djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Dërgesat e emigrantëve (flukse neto, në milionë euro, majtas) dhe financimi i deficitit tregtar nga të ardhurat neto parësore, dytësore dhe nga shërbimet (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

#### HAPËSIRË INFORMUESE: ZHVILLIMET NË HENDEKUN E KURSIMEVE DHE INVESTIMEVE


Hendeku kursime-investime i sektorit privat u vlerësua në -4.7% të PBB-së nominale (vlera negative e hendekut nënkupton investime më të larta se kursimet) për tremujorin e tretë të vitit 2019. Ky raport është 0.3 pikë përqindje më i ulët krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Raporti i investimeve private ndaj PBB-së nominale vlerësohet në nivelin 17.9%, ndërkohë që një vit më parë vlerësohej në 19.0%. Nga ana tjetër, kursimet private ndaj PBB-së nominale vlerësohen në nivelin 13.3%, 0.8 pikë përqindje më të ulëta se një vit më parë. Në tërësi, dinamika e investimeve ka dhënë kontributin kryesor në ngushtimin e hendekut negativ në sektorin privat, ndërkohë që kursimet kanë ndikuar në kahun e kundërt.



Në rastin e sektorit publik, hendeku është i mbyllur (0% ndaj PBB-së), ndërkohë që një vit më parë shënonte tepricë pozitive në 0.4% ndaj PBB-së. Kursimet publike vlerësohen në nivelin 4.1% ndaj PBB-së nominale me një pakësim vjetor prej 0.5 pikësh përqindjeje. Po ashtu, investimet publike u vlerësuan në 4.1% ndaj PBB-së nominale, me një pakësim prej 0.1 pikësh përqindjeje vit mbi vit. Në këtë mënyrë, pakësimi i kursimeve publike ka nxitur edhe zvogëlimin e tepricës pozitive të sektorit publik.

Raporti i investimeve kombëtare ndaj PBB-së është ngushtuar me 1.2 pikë përqindje në terma vjetorë. Nga ana tjetër, raporti i kursimeve kombëtare ndaj PBB-së nominale është pakësuar me 1.3 pikë përqindje. Zvogëlimi i raportit të kursimeve kombëtare ka qenë kështu përcaktues kryesor në zgerimin e deficitit korrent në terma vjetorë.

Grafik 5. Kontributi i treguesve të investimeve dhe kursimeve në dinamikën e deficitit (majtas) dhe kontributi i tyre në ndryshimin vjetor të deficitit të llogarisë korrente (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave.

### III. LLOGARIA KAPITALE


Teprica pozitive e llogarisë kapitale ishte rreth 19.7 milionë euro në tremujorin e tretë të vitit 2019, rreth rreth 3.2 milionë euro më e ulët krahasuar me një vit më parë. Flukset kapitale neto në këtë llogari vlerësohen në 0.6% ndaj PBB-së nominale. Transfertet kapitale neto për llogari të “qeverisë së përgjithshme” ishin tepricë pozitive prej 2.7 milionë eurosh, ndërsa ato të “korporatave financiare dhe jofinanciare, ekonomive shtëpiake dhe institucioneve jofitimprurëse në shërbim të ekonomive shtëpiake”, ishin 16.5 milionë euro.

Kombinimi i transaksioneve neto të llogarisë korrente dhe asaj kapitale jep pozicionin neto të ekonomisë vendase si huadhënës neto (suficit) dhe huamarrës neto (deficit), kundrejt ekonomive jorezidente. Në terma sasiorë, për tremujorin e tretë të vitit 2019, ekonomia jonë paraqet një pozicion neto huamarrës prej 141.5 milionë eurosh, i cili financohet nga llogaria financiare dhe zëri “gabime dhe harresa”. Ky nivel rezulton 14.6% më i lartë krahasuar me një vit më parë, por 47.2% më i ulët krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

### IV. LLOGARIA FINANCIARE

Llogaria financiare regjistroi detyrime neto në vlerën 15.4 milionë euro për tremujorin e tretë të vitit 2019, rreth 8.8% më të ulët krahasuar me një vit më parë. Detyrimet neto të kësaj llogarie u vlerësuan në rreth 0.4% të PBB-së nominale dhe financuan 9.6% të deficitit korrent të regjistruar gjatë kësaj periudhe.

Grafik 6. Llogaria financiare dhe gabime e harresa (flukse neto, në milionë euro)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Mjetet e rezidentëve u shtuan me rreth 195.2 milionë euro. Konkretisht, janë zgjeruar mjetet në formën e “Rezervës” dhe “Investimeve të portofolit”.

Në rastin e detyrimeve, fluksi i përgjithshëm rezultoi 210.6 milionë euro, rreth 6.0% më i ulët krahasuar me një vit më parë. Ndikimi kryesor në këtë drejtim lidhet me pakësimin e detyrimeve në formën e “Investimeve të tjera” dhe “Investimeve të portofolit”. Nga ana tjetër, flukset hyrëse të investimeve direkte u zgjeruan me 1.4%. Flukset e detyrimeve të investimeve direkte llogariten në rreth 7.8% të PBB-së. Për tremujorin në analizë, flukset neto të investimeve direkte financuan rreth 163.6% të deficitit të regjistruar korrent. Ky raport ishte 20.0 pikë për qindje më i ulët se i njëjti tremujor i një viti më parë.


Nënllogaria e investimeve të portofolit, raporton për një tepricë neto të mjeteve në nivelin prej 90.8 milionë euro, ndërkohë që një vit më parë raportohej një tepricë neto e mjeteve në masën 13.1 milionë euro. Ndikimi kryesor lidhet me rritjen e mjeteve të “korporatave depozitë-marrëse” në formën e “detyrimeve të borxhit”. Nga ana tjetër, detyrimet në këtë nënllogari janë pakësuar përsëri nga ndikimi i “detyrimeve të borxhit”. Në rastin e nënllogarisë së investimeve të tjera, është verifikuar një pakësim i përgjithshëm i mjeteve me 4.4 milionë euro. Mjetet e pakësuara janë ato të formës së huasë së “korporatave depozitë-marrëse”, por këto janë kompensuar disi nga rritja e mjeteve në formën e “monedhave dhe depozitave”. Paralelisht, detyrimet në formën e “Investimeve të tjera” janë pakësuar me 52.0 milionë euro. Kontributet lidhen me detyrimet në formën e “huasë” së “korporatave depozitë-marrëse” dhe të “qeverisë së përgjithshme”.

Grafik 7. Përbërësit e llogarisë financiare (flukse neto, në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 8. Përbërja e investimeve direkte (flukse, në milionë euro, majtas) dhe raporti i financimit të deficitit korrent prej investimeve direkte neto (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me një zgjerim të mjeteve të rezervës në masën 109.7 milionë euro. Në fund të muajit shtator 2019, stoku i rezervës valutore ishte rreth 3.4 miliardë euro. Ky nivel vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 6.7 muajve import mallrash dhe shërbimesh ose 160% të borxhit të jashtëm afatshkurtër bruto. Së fundi, llogaria “gabime dhe harresa neto” rezultoi në një fluks hyrës prej 126.0 milionë eurosh, i cili vlerësohet në 3.6% ndaj PBB-së nominale.

Grafik 9. Gabime dhe harresa ndaj PBB-së nominale (% majtas) dhe ndaj deficitit të llogarisë korrente (% djathtas)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## V. PROFILI I FINANCIIMIT TË DEFICITIT KORRENT

Qëndrueshmëria e financimit të deficitit korrent, përcaktohet nga ecuria e flukseve hyrëse borxh-krijuese, kundrejt flukseve hyrëse më të dëshirueshme joborxh-krijuese<sup>3</sup>. Kështu, flukset financiare joborxh-krijuese nga investimet direkte neto dhe nga llogaria kapitale u vlerësuan në nivelin 8.2% ndaj PBB-së nominale. Këto ishin rreth 0.9 pikë përqindje më të ulëta krahasuar me një vit më parë. Flukset financiare borxh-krijuese u vlerësuan në nivelin -4.0% ndaj PBB-së nominale, rreth 1.0 pikë përqindje më të ulëta krahasuar me një vit më parë.

Grafik 10. Flukset hyrëse financiare borxh-krijuese dhe joborxh-krijuese ndaj PBB-së nominale (majtas) dhe financimi në total i deficitit të llogarisë korrente (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>3</sup> Kjo ndarje shërben për të monitoruar ndikimin që flukset financiare e kapitale kanë në borxhin e jashtëm të vendit. Flukset joborxh-krijuese përfshijnë Investimet Direkte dhe hyrjet neto të llogarisë kapitale, ndërsa flukset borxh-krijuese përfshijnë investimet e portofolit dhe investimet e tjera neto.

Pasi flukseve valutore neto borxh-krijuese dhe joborxh-krijuese në tërësi u shtohen edhe gabimet dhe harresat neto, përftohet masa e financimit të përgjithshëm të deficitit korrent. Gjatë tremujorit në analizë, raporti i financimit të llogarisë korrente ishte në nivelin 168.1%, duke u përkthyer në një rritje të rezervës me 109.7 milionë euro. Ky raport rezultoi rreth 37.7 pikë përqindje më i ulët krahasuar me një vit më parë, por 83.6 pikë përqindje më i lartë krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

Tabelë 1. Tregues të bilancit të pagesave (të dhëna në milionë euro)

	T1'18	T2'18	T3'18	T4'18	T1'19	T2'19	T3'19
<b>Llogaria Korrente (në mil euro)</b>	<b>-178.4</b>	<b>-169.4</b>	<b>-146.4</b>	<b>-372.2</b>	<b>-245.2</b>	<b>-280.4</b>	<b>-161.2</b>
vmv (%)	13.3	-33.8	2.5	20.1	37.4	65.5	10.1
/ PBB-së (%)	-6.3	-5.0	-4.5	-11.0	-8.0	-7.8	-4.6
<b>Mallra dhe shërbime</b>	<b>-358.3</b>	<b>-427.2</b>	<b>-359.7</b>	<b>-614.8</b>	<b>-403.7</b>	<b>-518.9</b>	<b>-376.8</b>
<b>vmv (%)</b>	<b>14.9</b>	<b>-12.2</b>	<b>-3.8</b>	<b>7.8</b>	<b>12.7</b>	<b>21.5</b>	<b>4.8</b>
Eksporte, f.o.b.	841.8	1024.0	1240.4	952.8	885.2	1058.2	1345.0
vmv (%)	8.8	14.5	11.7	8.8	5.2	3.3	8.4
Importe, f.o.b.	1200.1	1451.2	1600.1	1567.6	1288.9	1577.1	1721.8
vmv (%)	10.6	5.1	7.8	8.4	7.4	8.7	7.6
Udhëtime neto	77.6	83.5	197.1	72.1	75.9	81.5	254.9
<b>Të ardhura parësore</b>	<b>-22.8</b>	<b>19.8</b>	<b>-17.1</b>	<b>6.3</b>	<b>-32.7</b>	<b>-10.0</b>	<b>-39.9</b>
Kredi	70.3	123.6	94.0	105.0	78.7	132.5	108.7
Debi	93.1	103.8	111.0	98.7	111.4	142.5	148.6
Të ardhura neto nga Investimet Direkte	-69.4	-81.2	-83.9	-48.1	-74.6	-111.2	-110.2
<b>Të ardhura dytësore</b>	<b>202.7</b>	<b>238.0</b>	<b>230.4</b>	<b>236.4</b>	<b>191.2</b>	<b>248.6</b>	<b>255.6</b>
Kredi	224.5	260.9	254.8	265.2	220.1	274.2	280.8
Debi	21.7	22.9	24.4	28.8	28.9	25.6	25.2
Dërgesa nga emigrantët -neto	148.6	181.7	170.0	169.2	150.2	185.2	184.6
vmv (%)	10.0	11.7	2.6	-1.7	1.0	1.9	8.6
<b>Llogaria kapitale</b>	<b>18.3</b>	<b>21.2</b>	<b>22.9</b>	<b>41.6</b>	<b>17.9</b>	<b>12.3</b>	<b>19.7</b>
<b>Huamarrje neto/Huadhënie neto</b>	<b>-160.1</b>	<b>-148.2</b>	<b>-123.5</b>	<b>-330.6</b>	<b>-227.3</b>	<b>-268.0</b>	<b>-141.5</b>
<b>Llogaria financiare</b>	<b>-285.2</b>	<b>-198.0</b>	<b>-16.9</b>	<b>-271.0</b>	<b>-371.1</b>	<b>-353.2</b>	<b>-15.4</b>
vmv (%)	-3.6	-4.1	-92.4	32.0	30.1	78.4	-8.8
/ PBB-së (%)	-10.1	-5.9	-0.5	-8.0	-12.1	-9.8	-0.4
<b>Investime direkte</b>	<b>-290.3</b>	<b>-218.2</b>	<b>-268.7</b>	<b>-244.9</b>	<b>-287.2</b>	<b>-227.5</b>	<b>-263.6</b>
vmv (%)	40.6	-3.4	-21.0	10.7	-1.1	4.3	-1.9
<b>Investime portofoli</b>	<b>5.5</b>	<b>108.3</b>	<b>13.1</b>	<b>-203.0</b>	<b>-0.2</b>	<b>-82.4</b>	<b>90.8</b>
Derivativë financiarë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
<b>Investime të tjera</b>	<b>142.0</b>	<b>-173.3</b>	<b>83.9</b>	<b>-96.9</b>	<b>-12.9</b>	<b>0.4</b>	<b>47.6</b>
<b>Mjetet e rezervës</b>	<b>-142.4</b>	<b>85.1</b>	<b>154.8</b>	<b>273.9</b>	<b>-70.7</b>	<b>-43.6</b>	<b>109.7</b>
<b>Gabime dhe harresa</b>	<b>-125.1</b>	<b>-49.8</b>	<b>106.5</b>	<b>59.7</b>	<b>-143.8</b>	<b>-85.1</b>	<b>126.0</b>

Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT dhe vlerësime të autorit.

